

Craig CZURY

KAM FRIKË TA THEM
I'M AFRAID TO SAY

Përktheu:
Silke Liria BLUMBACH

Biblioteka: PUHIZA

Redaktor: Ahmet SELMANI

Ballina: Savash VELIU

Library: PUHIZA

Redactor: Ahmet SELMANI

Front page: Savash VELIU

Craig CZURY

I MBIKËQYRUR MBI LËKURË DHIE

Përktheu
Silke Liria BLUMBACH



MLN "Ditët e Naimit"
Tetovë, 2006

Craig CZURY

STAKED-OUT ON GOATSKIN

Translation
Silke Liria BLUMBACH



IMLN "Ditët e Naimit"
Tetovë, 2006

për/for Shaip Emërllahun

I

SHËTIS DHE MENDOJ

në periferi
klithma ime gurgullon brenda
deri në qendrën e klithmës sate
ujë që gurgullon në një gur deri në zemrën e tij

Tetovë, Maqedoni

I

TO WALK AND TO DREAM

on the periphery
my cry ripples inward
to the center of your cry
water rippling a stone to its heart

Tetova, Macedonia

TETOVA

në atë që do të ishte dukur si mbeturina
e vura kokën time
në atë që do të ishte dukur si zemra jote
vetvetiu ikën këpucët e mia në male
këpucët e mia të lodhura nga shkumbi
u bëra më i lehtë
duke thithur flokët e tua në frymë
nëpër qiellin e mbrëmjes gëlonin garguj
në atë që do të kishte qenë zëri yt
që më thërret për lutje
u ktheva me mendimin më të thjeshtë
për një puthje
ngjyrë gështenje sytë e tu
në atë që do të kishte qenë
një dhënie e lashtë
në të dyja anët e derës

TETOVA

in what would have appeared to be rubble
i laid my head
in what would have appeared to be your heart
on their own my shoes walked off into
the mountains
my tired cindered shoes
i grew lighter breathing your hair
across the evening sky starlings swarmed
in what would have been your voice calling
me to prayer
i returned with the most simple thought
of a kiss
chestnut brown your eyes
in what would have been an ancient giving
on either side of the door

NJERIU JETON VETËM NJË HERË

shumë herë
e dërgoj këtë në erë
i shtrirë në një faqe mali
si një hartë e mbikëqyrur mbi lëkurë dhie në
të gjitha kuadrantet
me plejadën e vendeve që nuk kanë kufij

Shaipi	Naimi	Ahmeti
Lindita	Artani	
Hamziu	Biba	Lirimi
Elvana	Saludimi	
Jetmiri	Shevali	Isufi
Fatmiri	Valdrina	
Valoni	Nesrini*	

një kontinent i tërë

**(emrat e shokëve shqiptarë që jetojnë në Maqedoni,
poetë, gazetarë, përkthyes dhe studentë)*

A MAN LIVES ONLY ONCE

many times
i am hearing this in the wind
stretched out on a mountainside
like a map staked-out on goatskin at all
quadrants
with the constellation of countries that have
no borders

Shaipi	Naimi	Ahmeti
Lindita	Artani	
Hamziu	Biba	Lirimi
Elvana	Saludimi	
Jetmiri	Shevali	Isufi
Fatmiri	Valdrina	
Valoni	Nesrini*	

one continent alone

**(names of Albanian friends living in Macedonia, poets,
journalists, translators and students)*

ÇDO MËNGJES

kjo është imja
mendon ai duke mësuar fjalët e tyre
tung ju lutem falemnderit
pretendim të dish
t'i përkasësh
këto ditë kanë qenë të shkëlqyeshme
shëtis dhe mendoj *
aq afër sipërfaqes
natën ai braktis fantazmën e vet

* *Shqip në origjinal.*

EVERY MORNING

this is mine
he thinks learning their words
tung julutem foleminderit
pretense to know
to belong
these days have been glorious
shetis dhe mendoj
this close to the surface
at night he abandons his ghost

* *tung: hi. ju lutem: please. foleminderit: thank you.
shetis dhe mendoj: to walk and to dream*

KRAHË ZOGU QË E KTHEJNË NATËN

në një mal
në një luzmë errësire
dikush fle pranë dritares
ti kalon sikur të ishe nga një shekull tjetër
lumi pastron eshtrat e vet me ëndrra peshku
penis i trishtuar patetik
pse të shkosh më larg
mizat kanë bartur qentë e tyre të zgjebosur
në shtëpi në rrjetat e tyre
çdo gur kalldrëmi ofron një nyell shpresë
në krahasim me mbetjen
e shtrirë dhe lutëse
nyelli mjafton

WINGS THAT TURN THE NIGHT

into a mountain
into a swarm of darkness
someone sleeps at the window
you pass as if from another century
the river cleanses its bones with the dreams
of fish
sad pathetic penis
why go any further
the flies have carried their mangy dogs home
to their webs
each cobble offers an ankle of hope
compared to the rest
prostrate and pleading
ankle is enough

PËRGJATË LUMIT

një mjegull e thellë e shkrumbon erën
qielli dhe toka në zjarr
në një oreks të hirtë të padepërtueshëm
që gëlltit gurë dhe rrugë
unë mbledh sendet e mia nga jehonat
e zërave që i kërcëllijnë njëri-tjetrit
ec nga të gjitha drejtimet
i papeshë dhe në rrotullime
diçka prek lehtë këmbën time
këmbët e mia qiellin
koka ime, tokën
diçka prek lehtë supin tim
një siluetë biçiklete
e ngarë nga dikush
kam frikë ta them
nga frika të them se jam njëri prej tyre

ALONG THE RIVER

an intense fog incinerates the air
sky and earth on fire
in an impenetrable gray appetite
swallowing stone and street
i gather my bearings from the echoes
of voices clanging off each other
from all directions i step
weightless and spinning
something brushes my leg
my feet the sky
my head the earth
something brushes my shoulder
a silhouette of a bicycle
ridden by a
i'm afraid to say
for fear of saying i'm one of them

DHE NË MES TË THËNIES

ja ku jam ja ku banoj
zëri im merr një këngëzim
e njëfarë pasigurie
gati i humbur në vetën në një hapësirë
aq të hapur
nuk të them dot se si e di ç'do të thotë
ky çast i shkurtër që nuk shpie asgjëkund
i kërkuar

AND IN THE MIDDLE OF SAYING

this is where i am this is where i live
my voice takes on an intonation
of somehow being unsure
almost lost in itself in such open space
i can't tell you how i know what that means
this short moment leading nowhere
sought

KËTU

le ta shkruajmë këtë vend askund
dhe atë që e shkruan, askënd
dhe ta bëjmë thjesht asgjë
dhe ta bëjmë më thjesht gjithçka
të bëhet me asgjë
për askënd lexuesin
askund asnjëherë

le ta vendosim këtë shkrimtar askund
dhe mendimet e tij thjesht
gjithçka brenda lexuesit
dikush ta bëjë me asgjë më thjesht
se herët e një fjale
çdo herë që nuk shqiptohet asnjëra

le ta shkruajmë këtë fjalë kudo
për askënd në atë vend jashtë shkrimtarit
dëgjimi i herëve jo më i lehtë se
dikush diku
asnjë lidhje me ty botë

dhe shkruaje këtë botë askund thjesht
në fjalën e saj të lexuar nga çdokush
brenda asgjësisë së tyre këto herë
kudo pa mendim
shkrimtari i saj krimbi i saj

HERE

let's write this place nowhere
and the one writing it anyone
and make it simple nothing
and make it simpler everything
to do with nothing
for no one the reader
anywhere no time

let's place this writer nowhere
and his thought simply
everything inside the reader
anyone to do with nothing simpler
than the times of a word
every time no one's spoken

let's write this word everywhere
to no one in that place outside the writer
listening to the times no simpler than
anyone anywhere
nothing to do with you the world

and write this world nowhere simple
in its word read by everyone
inside their nothing these times
everywhere without thought
its writer its worm

NGANJËHERË

nuk është braktisja
vetëm largimi
por nga cila hijeshi të largohem pas kësaj
mbyllja
si në grumbullimin e të gjitha dëshirave të mia
pasi u rrita më i madh nga secili prej jush
gjithë vigjilenca ime
rruga ime nga cili gjest
do të ruhet ose të drejtohet
mbërthimi i ngushtë i palltos sime
zëri i kujt do ta mbajë vijën të tendosur
thjesht ikja

SOMETIMES

it's not leaving
just going away
but from which grace shall i go next
closing
as in gathering all my desires
having grown larger from each of you
all my watchfulness
from which gesture shall my way
be guarded or guided
pulling my coat tight
whose voice to keep the line taut
simply walking off

KJO ËSHTË NATA E FUNDIT BASHKË

hera e fundit duke u ulur dhe ditur
diçka midis nesh lëviz
nga gjatësi të kundërta
diçka lëviz midis nesh në gjatësinë e njëjtë
nga skaje të kundërta
e kundërta herë e fundit
diçka e njëjta lëviz midis nesh
më afër shtëpisë

THIS IS THE LAST NIGHT TOGETHER

this is the last sitting and knowing
something between us moves
from opposite lengths
something moves between us the same length
from opposite ends
opposite the last time
something the same moves between us
closer to home

EKTO

pluhur zë vend në një zë
që vishet me dëshira të vjetra
mjaft është gjithmonë një lypje dytësore
diçka jashtë më thërret
për të jetuar më afër eshtrave të mia
dhe përgjigjem me hijen time
të thurur me alga deti dhe guaska gaforresh
këmbënofullat e flokëve të mia
të plandosura nëpër deltinë

ECTO

dust settles in a voice
that coats itself with old wishes
enough is always a secondary plea
something outside calls me
to live closer to my bones
and i respond with my shadow
woven with seaweed and crabshells
the tentacles of my hair
sprawled across the loam

PESHQIT

pikërisht ajo që e harrova
doli dhe kërkoi veten
në drejtime të kundërta
nga ajo që me kujtohej
pluskon drejt sipërfaqes
noton rrrathë
të lëmuara monotone
më këndon ninulla çdo ditë
çdo ditë vetëm kaq gjumë
për të ma dhënë fuqinë natën
të dal të kërkoj

PISCES

precisely what i forgot
went looking for itself
in opposite directions
from what i remembered
floating to the surface
swimming smooth
monotonous circles
singing me to sleep each day
each day just enough sleep
to give me the strength at night
to go looking

NË SKAJ

muri
mali
kopshti
mbajnë mesin e tyre kundër një bregdeti të
lëkundur
faqja
qielli
dritarja
mbajnë bregdetin e tyre kundër një dere të
lëkundur
kthehu dhe kalo
kthehu

AT THE EDGE

the wall
the mountain
the garden
holding their center against a wavering
shoreline
the page
the sky
the window
holding their shoreline against a wavering door
turn and walk through
turn around

TJETËR NUK KISHTE

në rishikim
kokë më kokë
ajo që lëvizte u bë çuditërisht
një pezullim u ktheva drejt
teje në të kaluarën të ardhmen të tashmen
lartësia dhe reja mbulojnë
këdo që hapi me lopatë këtë platformë
dhe që është tani i ulur si unë
i pakohshëm midis

THERE WASN'T ANY OTHER

looking back
eye in eye
what moved became a curious
suspension i turned to
you in the past future perfect
altitude and cloud cover
whoever shoveled this platform
is now sitting as i am
timeless between

II.

AKT BALANCIMI

kjo ishte rruga ime para se të dija se kisha
një rrugë
kjo ishte ecja dhe bërja ime
një pyetje ajri e papërgjigjur nga drita
dhe që hap një faqe drite
midis verbërisë dhe marramendjes
një dhomë shëtit në një dhomë tjetër ku
barrierat
janë mendimi i trashë përsëritës me të cilin
disa prej nesh mësohen

Vilnius, Lituani

II.

BALANCING ACT

this was my way before i knew i had a way
this was my going and becoming
a question of air unanswered by light opening
a page of light
between blindness and vertigo
one room walking into another where the
barriers
are a coarse repetitive thinking some of us
get used to

Vilnius, Lithuania

ky është horizonti
dhe sorollatet
 më thellë se në periferi
pa marrë parasysh si definohet
 ose vezullon
 nga poshtë
fillon të flasë

unë këtë gjuhë e arrij
 nëpër një heshtje të gjatë

this is the horizon
and it lingers
 deeper than peripheral
no matter how defined
 or shimmering
 underneath
begins to speak

i reach this language
 across a long silence

KARTOLINË NGA VILNIUS

*nuk kam gjuhë të flas kaq andej
ose në ndonjë njohuri personale
të them po edhe unë kështu e kam punën*

me kohë
mënyra se si ishim bashkë
do të rritet t'i ngjajë një rrugë
për t'u sorrollatur për të kaluar
sidomos për të qeshur
atë çast më të përzemërt šudas-fuck absurd
të shkurtër
që bota nuk na ka kapur ne
vështrimin tonë kalimthi ose ngulimin e syve
në shikimin i dijes se ende nuk na vranë
po dhe nëse ta bënin s'do të kishte rëndësi
në këto shenja të para jetëshkurtra të një
buzëqeshjeje
vetëm për të qeshur

(šudas - mut)

POSTCARD FROM VILNIUS

*i have no language to speak this beyond
or in some personal knowing
to say yes it's like that with me too*

in time
how we've been together
will grow to resemble a way
to linger to pass by
especially to laugh
that heartiest šudas-fuck absurd
brief moment
that the world didn't get us
glance or gaze
look of knowing they didn't kill us yet
or even if they did it didn't matter
in those first ephemeral signs of a smile
just to laugh

(šudas - shit.)

këto janë vendimet
për të shkruar
ose
shkoqur jo mjaft për të folur
(mendim i fshirë nga një mendim tjetër)
tepër të gjalla ose të zhdërvjellëta
kjo është zënka ime me kujtesën
që ndodh pa ty

these are the decisions
to write
or
clearly not enough to speak
(thought effaced by other thought)
too vivid or unravelling
this is my argument with memory
happening without you

ai thotë shkruaje mendjen tënde
por është mendja jote e cila të ka këtu
ai thotë shkruaje atë që po mendon
por mënyra si mendon të solli këtu
ai thotë shkruaje atë që di
por për shkak të asaj që di qenke këtu
ai thotë

humnera ishte afër por jo e përfunduar
njëra anë mbetej prapa

he says write your mind
but it's your mind that has you here
he says write what you're thinking
but how you're thinking is what got you here
he says write what you know
but what you know is why you're here
he says

the divide was close but not complete
one side lagged

KARTOLINË NGA KAUNAS

nuk është gjithmonë e njëjta natë
fjalët familjare të shkruara pa letër
nuk janë gjithmonë fjalët e njëjta
bëj numrin tënd në një kabinë telefonike
pa monedha
linjë me linjë
i vendos në vazon në fund të barit
ishte nata më e ftohtë në Evropë
hoteli më i vjetër
nuk është gjithmonë e njëjta zgjatje
me një parfum të veçantë mbi gishtat e mi
çarçafi më i hollë
midis borës dhe adrenalinës
korridorit më i errët
ti me të cilën flas vazhdimisht në një gjuhë të
vdekur
hijet më ogurzeza
unë të njoh tepër mirë për të kërkuar ndjesë
qeshje më e dashur femrash

POSTCARD FROM KAUNAS

it isn't always the same night
the familiar words written without paper
they aren't always the same words
dialing your number in a phone booth
without coins
line to line
posted in the vase at the end of the bar
it was the coldest night in Europe
the oldest hotel
it isn't always the same reaching
with a certain scent on my fingers
the thinnest blanket
between snow and adrenalin
the darkest corridor
you who i continually talk to in a dead
language
the most sinister shadows
i know you too well to beg forgiveness
the loveliest laughter of women

kur shkova kur ti thirre emrin tim

në cilën nuancë u fundosa
si i fshehur në sekret ose në një mjegull të errët

para shumë kohe më shtrove një pyetje
tani po filloj të parafytyroj

dhe si më parë ti nuk më gjen dot

where did i go when you called my name

in which undertone did i sink
as if hidden in secret or a dark mist

long ago you asked me a question
i'm now beginning to imagine

and as before you can't find me

Q

çfarë më ka tërhequr në këtë të ftohtë

cilat rryma shtegtare në gjak

ishte e lehtë të besoja se do të bëhesha
dikush tjetër
më i thellë
i përhumbur

sikur nga një ëndërr të zgjohesha
në një pyetje zërash

Q

what was it that drew me into this cold

what migratory currents in the blood

it was easy to believe i'd become someone
else
deeper
haunted

as if from a dream waking into
a question of voices

KARTOLINË NGA VILNIUSI

degë hijesh

me bullunga kundër një mur llaçi
vendkalimi i shtruar me gurë varri
nga varreza e vjetër hebraike
në një botë tjetër
ati yt nuk do të kthehet
as motra e tij e vogël nuk do të kthehet
as mos i përmend seneliai-t
më thellë më poshtë
emrat e tyre të shpuar me rrënjë
disi pak më të kujdesshëm
na duhet ngritur njërën këmbë më lart
për të mos u qorrollisur duke shikuar

(seneliai – të vjetrit.)

POSTCARD FROM VILNIUS

shadow branches

gnarled against a plaster wall
the walkway paved with headstones
from the old jewish cemetery
in another world
your father won't return
his little sister won't return either
don't even mention the seneliai
deeper down
their names riddled with roots
a little more careful
having to lift one foot higher not to trip while
looking

(seneliai - old ones.)

KARTOLINË NGA KLAIPEDA

dikush pyet se ç'të përkushtohet ty
ç'të udhëheq ose ta përcakton drejtimin

unë shikoj prapa nga një varg poezie
të vizatuar nëpër dritare

vijë poezie nëpër horizontin
të vizatuar nëpër sytë e mi

dhe flas drejtpërdrejt në një dhomë të zbrazët

fytyra jote më udhëheq për në det

POSTCARD FROM KLAIPEDA

somebody asks what dedicates itself to you
what guides or sets your direction

i look back from a line of poetry
drawn across the window

line of poetry across the horizon
drawn across my eyes

and speak directly into an empty room

your face leads me into the sea

KARTOLINË NGA VILNIUSI

por hëna do të ishte një fytyrë tjetër
pa këtë natë

dhe unë do të isha një burrë tjetër
me mendime të tjera midis nesh
dritarja flet poezinë e vet të verbër
në shkëlqimin verbues kalimtar të fenerëve
dëgjoj se si flet në dhomën tjetër
në anën tjetër
si zakonisht të përgjigjem
larg në dhomën time të ngatërruar
ti heq dorë nga përpjekja për të kuptuar
dhe hëna më tërheq më afër
duke ndjekur këmba-këmbës bulevardet e gurit
duke rrufitur pemët

POSTCARD FROM VILNIUS

but the moon would be another face
without this night

and i would be another man
with other thoughts between us
the window is speaking its own blind poetry
in the passing glare of headlights
i hear you talking in the next room
on the other side
as usual i answer you
faraway in my garbled room
you give up trying to understand
and the moon pulls me closer
dogging the stone alleys
sniffing the trees

III

FJALA: Lëvozhga, Guaska, Lëkura

Në cilën klasë nuk mbetet fjala “Zoti” – në
cilën fjalë me mend
dhe cilën lutje për mëshirë?

një derë balancohet mbi një shkëmb
midis tokës
dhe një trokitjeje të lashtë

Në cilën kthesë të befasishme të veshit nuk
mbetet mrekullia e
“Kush është?”

Reading, Pennsylvania

III

WORD: The Husk, The Shell, The Rind

In which classroom doesn't the word God
remain—in which wisecrack
and plea for clemency?

a door balances on a rock
between the earth
and an ancient knocking

In which sudden turning of the ear doesn't
the wonder of Who's there?
remain?

Reading, Pa.

MENDIM KONSIDERUES:

një ide mendimi në formë të një ideje,
informuar për një ide... ndoshta vështrimi
anash i kujtesës – një vëzhgim plotësisht i
ngulur pas një lustrimi për një thyesë sekonde
që të mbush plot me depërtim dhe njohuri.

Konsiderimi, një herë i shkruar, do të thotë
të heqësh dorë nga intuita. Ti, shkrimtar,
heq dorë nga kuptimi yt, synimet e tua të
kuptimit, për të çliruar shkrimin, që të kërkojë
mundësitë e veta

në jermin tënd, rendi yt i rastësishëm i fjalëve
gjen synimet më të thella në dëgjimin tënd,
duke bashkuar zë që jehon në zgavrën
harmonikisht të pjekur të veshit tënd... sytë e
tu ngriten në një hapësirë më të gjerë
nga leximi

ideja kalimtare e lënë në mëshirë të rastësisë,
e shkruar, duke informuar një kujtesë më të
thellë prej kaosit të një hapësire që ngul sytë
me një vështrim anash deri në depërtim më
të gjerë, të pasur në zgavrën e një sekonde
të thyer.

CONSIDERING THOUGHT:

an idea of thought in form of an idea,
informed of an idea...perhaps memory's side
glance - a full stare observation after a split-
second glossing over that fills you rich with
insight and knowing.

Consider, once written, meaning
abandoning intention. You, the writer,
abandoning your meaning, your intentions of
meaning, to free the writing to go looking for
the possibilities of its own

in your trance, your chance order of words
finding their deeper intentions in your
listening, piecing together sound echoing
sound in the harmonious ripe hollow of your
ear ...your eyes look up into a wider space
from reading

the transitory idea abandoned to chance,
written, informing a deeper memory out of
the chaos of a side glance staring space into
wider insight, rich in the hollow of a split
second.

SHPEJTËSIA E GRILËS SË KAMERËS

Unë jam më i qetë se kurrë duke lexuar tonalitetet e zërave, gjesteve dhe syve. Ja kush jam, i dyti nga e majta me dhëmbin që mungon, që spërdredh fytyrën me sy të mbyllur.

Ti di ç'do të thotë kur dikush thotë diçka, dhe për t'u thonë se si e di atë që thonë, ti shohit të gjitha përvojat e tua dhe kthehesh me atë histori të veçantë nga jeta jote që bart një pasojë të ngjashme, duke zbuluar një shikim të shpejtë emocional ose pamor që thotë po, kështu më ndodhi mua, ata i përgjigjen nga shikimet e tyre të shpejta emocionale ose pamore, dhe ja që kemi filluar një bisedë?

Mes brezit tim, poetë nga ish-Sovjetiku, ish-Lufta e Ftohtë, Shqetësimet aktuale, Xhihad aktual. Pastrim etnik: Poetë. Gazetarë. Profesorë. Mbijetues. Që rrëshqasin brenda dhe jashtë burgjeve, strehëve, spitaleve psikiatrike, qendrave kolektive, shkollave...

SHUTTER SPEED

I am quieter than I've ever been, reading the tones of voices, gestures and eyes. That's me, second to the left with the missing tooth, squinching my face with my eyes closed.

You know how it is when someone says something and in order to let them know how it is you know what they're saying you sift through all your experiences and return with that one story from your life that conveys a similar consequence, revealing an emotional or visual glimpse that says yes, it was like that this way with me they respond to from their emotional or visual glimpses and we've begun a conversation?

Among my generation poets from the former Soviet, the former Dirty War, the current Troubles, current Jihad. Ethnic Cleansing: Poets. Journalists. Professors. Survivors. Sliding in and out of prisons, shelters, mental hospitals, community centers, schools.

Fotografi është i kërrusur mbi kamerën e vet dhe bërtet: Mos i kapsit sytë! Në të njëjtin çast, Nana zhvendoset në pozën e saj të kampiones në "bowling", Miklós Radnóti zhvarroset nga një varr masiv, gjak i përzier me baltë po thahej në veshin tim, poezia e tij e fundit, të cilën e lexoj në shkrepëtimën e llambës së mbuluar me gjak të tharë nga xhepi i palltos së tij. Shikim i shpejtë i pazhvilluar i Ana Ahmatovës, që ia ngul sytë prej mpirjes sonë të përbashkët të të gjithë neve në këto ditë, buzëqeshja e mekur e gruas që më ka lindur, buzët e saj të kaltra nga e ftohta. Ishte një kohë kur të vdekurit mund të buzëqeshnin, të çliruar nga luftërat e tyre. Plaku im lëshon një shtëllungë tymi cigare, e gjithë pasdita është llaç i rënë, gurë të zinj, gjemba të thatë. Pasdita ka një ngjyrë të vështirë të bërë nga hapa të vjetër të ndalur në mes të hapit. Yannis Ritsos nxjerr me kollë një pllujq gëlbase tuberkuloze. Ja kush jam, i dyti nga e majta, që shpon të qethurën karre me pëllëmbën e dorës, i shtrydhur midis Kafkës dhe Calvinos, që më mbështesin midis kuptimit dhe drejtimit. Natyrisht jam vonë për në shkollë. Gjithçka që më duhet dhe për të cilën e shtrij dorën duke vrapuar drejt derës më thyhet në duart. Kur e kap derën, nuk hapet. Nuk hapet, dhe zgjohem duke vrapuar nëpër oborret e fqinjve, ku gra varin çarçafë në tela, të cilët

The photographer's hunched over his camera screaming, All right now! The same moment Nana shifts to her champion bowling pose Miklós Radnóti is being exhumed from a mass grave, blood mixed with mud was drying in my ear, his last poem I'm reading in the bulb flash blood-crusting from his overcoat pocket. Underdeveloped glimpse of Anna Akhmatova staring out of the torpor common to all of us in those days, faint smile of the woman who gave birth to me, her lips blue from the cold. That was a time when the dead could smile. My old man exhales a plume of cigar smoke, the afternoon is all fallen plaster, black stones, dry thorns. The afternoon has a difficult color made up of old footsteps halted in mid-stride. Yannis Ritsos coughs up a glob of tubercular phlegm. That's me, second to the left, spiking my flat-top with the palm of my hand, squeezed between Kafka and Calvino, who prop me up between sense and direction. Of course I'm late for school. Everything I need and reach for as I'm racing for the door breaks off in my hands. When I grab the door it doesn't open. It doesn't open, and I wake up running through the neighbors' yards where women are hanging sheets on clotheslines I brush, tangle, and, pumping my arms, lift myself off the ground, up, clear of the clotheslines, clear of the power lines. I'm treading the air above

i prek dhe koklavis, dhe duke pompuar me krahët, shkëputem nga dheu, ngrihem, i lirë nga telat e rrobave, i lirë nga linjat e tensionit të lartë. E shkel ajrin mbi një turmë njerëzish të vockël, që më gjuajnë, kur zgjohem në prapaskenën e një auditori duke u paraqitur si një person shumë i rëndësishëm të cilin nuk e njoh, dhe më është rritur një mjekër. Duke dalë nëpër skenën, nuk mbaj rroba fare. Shtëpia është e mbushur plotë me të gjithë në smoking ose një fustan me model flokësh, unë eci mbrapa podiumit duke u ndier i mbrojtur kur filloj të lexoj nga një fletë letre të gjitha fjalët janë të përziera dhe nga goja ime del dërdëllitje kur zgjohem duke shurrur në shtrat jam i zbuluar me farë është ditëlindja ime dhe jam 50 vjeçar të gjithë shokët e mi janë adoleshentë

a crowd of tiny people who are chasing me when I wake up standing in the wings of an auditorium being introduced as a very important person I don't recognize and I've grown a beard. Walking out across the stage I'm not wearing any clothes. The house is packed with everyone in a tux or a gown with hairdos, I walk behind the podium feeling protected as I begin to read from a sheet of paper all the words are mixed up and what comes out of my mouth is gibberish when I wake up peeing the bed I'm covered with seeds it's my birthday and I'm 50 years old all my friends are teenagers

LIBRI: Një recension

Sa për librin, nuk ka as fillim, as mes, as fund. Ka vetëm fjalë dhe hapësirë të hapur. Hapësirë të hapur që mund ta lexosh, thuajse ta imagjinosh, nga e cila linden fjalë, derisa ti fillosh të bëhesh i gjallë atje (për librin, a ka më shumë se një heshtje?) për informacionin njëloj i ndritur se po të lexoheshin fjalët e tij – ngjyrë dhe tul.

E kam mbajtur librin në dorën time, në xhepin tim, në çantën time për një kohë shumë të gjatë para se ta hapi, duke njohur verbërinë e cila do të më duhej për të filluar leximin. Si po të dëgjohej një këngë e thellë e largët, njeriu duhet t'ia mbyllë gojën secilës këngë të tij, kjo formë verbërie, që sytë të ledhatojnë dhe mendja të formulon çdo shkronjë të huaj në rrokje në fjalë në vizion të heshtur autori i librit - i cili është heshtja përfundimtare - murmurin si mendim.

THE BOOK: A Review

As for the book, there is no beginning, no middle, no end. There are only words and open space. Open space you could read, almost imagine, words being born out of, until you begin to come alive there (for the book, is there more than one silence?) for the same enlightened information as reading its words—ink and pulp.

I have carried the book in my hand, in my pocket, in my satchel a very long time before opening it, knowing the blindness I'd need to begin reading. The way listening to a faraway deep song, one has to silence each of his or her own songs, this form of blindness, for the eyes to caress and the mind to formulate each foreign letter into syllable into word into silent vision the writer of the book—who is the ultimate silence—murmurs as thought.

Libri të ka folur tashmë dhe do të vazhdojë të të flasë pa ty. Mos u shqetëso. Prej shumë kohë, lidhja e tij ka humbur ngjitesin, dhe faqet e tij, të konsumuara dhe të zhubravitura, do të të flasin gjithmonë. Kështu u shkrua ky libër, të lexohet pa rend, në drejtim të kundërt, i sistemuar në raft ose diku në një papafingo midis kafes dhe njollave të gishtave të yndyrshme - historia e librit.

E kërkova librin përgjatë autostradave të Amerikës me gishtin e madh dhe e gjeta në dritat e frenave të tu. E kërkova librin në baret e tangos së Argjentinës me supet e mia dhe e gjeta në këmbët e tua përvëluese. E kërkova librin në dallgët e çdo deti duke folur heshtjen e rënës dhe gjeta autorin e tij, hënën – një histori tjetër e shkruar me bojë që zhduket.

The book has already been speaking to you, and will continue to speak to you without you. Don't worry. Its binding has long since unglued and its pages, worn and disheveled, no matter how awry or out of order, will always be speaking to you. The book was written this way, to be read out of order, backwards, shelved or scattered in an attic between the coffee and greasy finger stains— history of the book.

I went looking for the book along the highways of America with my thumb and found it in your brake lights. I went looking for the book in the tango bars of Argentina with my shoulders and found it in your fiery legs. I went looking for the book in the waves of each sea speaking the silence of sand and found its author, the moon—another story written in vanishing ink.

LIBRA TË TJERË NGA CZURY:

AMERICAN KNOW-HOW (Njohuri amerikane):
Patent pending (Patentë pezull), Paper Kite Press, 2006,
Wilkes-Barre, Pennsylvania.
GOD'S SHINY GLASS EYE (Syri i qelqit i shkëlqyer
i Zotit), FootHills Publishing, 2004, Bath, Nju Jork.
IN ATTESA DI BREVETTO / AMERICAN KNOW-HOW
(përkthyer në italisht nga Riccardo Buranti, ilustruar
nga Dino Patanè), Edizioni Empiria, 2003, Romë, Itali
TECNOLOGÍA NORTEAMERICANA - PATENTE EN
TRÁMITE- Y OTROS POEMAS / AMERICAN KNOW-
HOW -PATENT PENDING- AND OTHER POEMS
(përkthyer në spanjisht nga Esteban Moore), PapelTinta
Ediciones. 2003, Buenos-Ajres, Argjentinë
IN MY SILENCE TO JUSTIFY (Në heshtjen time për të
përligjur), FootHills Publishing, 2003, Bath, Nju Jork.
ANGLIAVAIZDIS / COALSCAPE (Pejsazh qymyri)
(përkthyer në lituanisht nga Mariaus Buroko) Vario
Burnos, 2002, Vilnius, Lituani
CLOSING OUT (Heqja qafe), FootHills Publishing,
2000, Bath, Nju Jork.
PARALLEL 'NOYE TECHNIE / PARALLEL RIVERTIME
(Koha paralele e lumenjve) (përkthyer në rusisht nga
Irina Mashinskaia), Petropol Press, 1999,
Petërsburg, Rusi
UNRECONCILED FACES (Fytyra të papajtuara),
FootHills Publishing, 1999, Bath, Nju Jork.
FACES IRRECONCILIÁVEIS / UNRECONCILED FACES
(përkthyer në portugalisht nga Narlan Matos), Brazil,
(i pabotuar)

OTHER BOOKS BY CZURY:

AMERICAN KNOW-HOW: Patent Pending, Paper Kite
Press, 2006, Wilkes-Barre, Pa.
GOD'S SHINY GLASS EYE, FootHills Publishing, 2004,
Bath, N.Y.
IN ATTESA DI BREVETTO / AMERICAN KNOW-HOW
(translated into Italian by Riccardo Duranti, illustrated
by Dino Patanè) Edizioni Empiria, 2003, Rome, Italy
TECNOLOGÍA NORTEAMERICANA - PATENTE EN
TRÁMITE- Y OTROS POEMAS / AMERICAN KNOW-
HOW -PATENT PENDING- AND OTHER POEMS
(translated into Spanish by Esteban Moore) PapelTinta
Ediciones. 2003, Buenos Aires, Argentina
IN MY SILENCE TO JUSTIFY, FootHills Publishing,
2003, Bath, N.Y.
ANGLIAVAIZDIS / COALSCAPE (translated into
Lithuanian by Mariaus Buroko) Vario Burnos, 2002,
Vilnius, Lithuania
CLOSING OUT, FootHills Publishing, 2000, Bath, N.Y.
PARALLEL 'NOYE TECHNIE / PARALLEL RIVERTIME
(translated into Russian by Irina Mashinskaia) Petropol
Press, 1999, St. Petersburg, Russia
UNRECONCILED FACES, FootHills Publishing, 1999,
Bath, N.Y.
FACES IRRECONCILIÁVEIS / UNRECONCILED FACES
(translated into Portuguese by Narlan Matos, Brazil,
(unpublished)

Autori falenderon Edicionin e 8-të të Festivalit
Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit"

The author would also like to thank The 8th Edition of
the International Poetry Festival "Ditët e Naimit"

*Disa prej këtyre poezive u botuan më parë në
ARS INTERPRES: Një gazetë ndërkombëtare për poezi,
përkthim dhe art.*

*Some of these poems have previously been
published in ARS INTERPRES: An International Journal
of Poetry, Translation & Art.*

PËRMBAJTJA

SHËTIS DHE MENDOJ	10
TETOVA	12
NJERIU JETON VETËM NJË HERË	14
ÇDO MËNGJES	16
KRAHË ZOGU QË E KTHEJNË NATËN	18
PËRGJATË LUMIT	20
DHE NË MES TË THËNIES	22
KËTU	24
NGANJËHERË	26
KJO ËSHTË NATA E FUNDIT BASHKË	28
EKTO	30
PESHQIT	32
NË SKAJ	34
TJETËR NUK KISHTE	36
AKT BALANCIMI	38
KARTOLINË NGA VILNIUS	42
KARTOLINË NGA KAUNAS	48
Q	52
KARTOLINË NGA VILNIUSI	54
KARTOLINË NGA KLAIPEDA	56
KARTOLINË NGA VILNIUSI	58
FJALA: Lëvzhga, Guaska, Lëkura	60
MENDIM KONSIDERUES:	62
SHPEJTËSIA E GRILËS SË KAMERËS	64
LIBRI: Një recension	70

CONTEST

TO WALK AND TO DREAM	11
TETOVA	13
A MAN LIVES ONLY ONCE	15
EVERY MORNING	17
WINGS THAT TURN THE NIGHT	19
ALONG THE RIVER	21
AND IN THE MIDDLE OF SAYING	23
HERE	25
SOMETIMES	27
THIS IS THE LAST NIGHT TOGETHER	29
ECTO	31
PISCES	33
AT THE EDGE	35
THERE WASN'T ANY OTHER	37
BALANCING ACT	39
POSTCARD FROM VILNIUS	43
POSTCARD FROM KAUNAS	49
Q	53
POSTCARD FROM VILNIUS	55
POSTCARD FROM KLAIPEDA	57
POSTCARD FROM VILNIUS	59
WORD: The Husk, The Shell, The Rind	61
CONSIDERING THOUGHT:	63
SHUTTER SPEED	65
THE BOOK: A Review	71

Boton
Manifestimi Letrar Ndërkombëtar "Ditët e Naimit"

Drejtor
Shaip Emërllahu

www.ditetenaimit.org.mk

U shtyp më vitin 2006,
në Shtypshkronjën "Tringa Desing", Tetovë

Tirazhi: 500 kopje

CIP - Katalogizimi në publikim
Biblioteka popullore dhe universitare "Sv. Kliment Ohridski", Shkup

821.111(73)-1

CZURY, Craig

Kam frikë ta them / Craig Czury ; përktheu Silke Liria Blumbach.
- Tetovë, Manifestimi Letrar Ndërkombëtar "DITËT E NAIMIT", 2003.
- 81 f. ; 17cm. - (Biblioteka PUHIZA)

ISBN 9989-2207-7-8

COBISS.MK - ID 65796362